

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER



METODOLOGJIA E NDERTIMIT

FAZA II: PROJEKT ZBATIMI

JANAR 2019

**1. STUDIM-PROJEKTIM 'MASA INXHINIERIKE PER STABILIZIMIN
E RRESHQITJES SE MASES NE KODREN E CFAKES, PRANE RRUGES
NACIONALE GJIROKASTER-KAKAVIJE**

**1.a. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK, SHPIME GJEOLOGJIKE+ANALIZA
LABORATORIKE PER OBJEKTIN E MASES NE KODREN E CFAKES, PRANE
RRUGES NACIONALE GJIROKASTER-KAKAVIJE**



PERGATITUR NGA BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE:
SEED CONSULTING JV ATELIER 4 JV T.T-SOIL & EARTHQUAKE CONSULTING

PERMBAJTJA

1	ORGANIZIMI I PUNIMEVE	2
1.1	<i>Hyrje</i>	2
1.2	<i>Te pergjithshme</i>	2
1.3	<i>Punimet per gatimore per zbatimin e projektit</i>	3
1.4	<i>Punimet ne zonen e rreshqitjes</i>	4
1.5	<i>Detyrimet e Kontraktorit gjate Punimeve ne zonen e rreshqitjes</i>	6
2	METODOLOGJIA E NDERTIMIT DHE ORGANIZIMI I PUNIMEVE.....	7
2.1	<i>Te pergjithshme</i>	7
2.2	<i>Objektivat e kryesore</i>	7
2.3	<i>Punime per ndertimin e masave stabilizuese te shpatit</i>	7
2.4	<i>Radha e realizimit te punimeve</i>	8
2.2	<i>Zona e Rreshqitjes Nr.1</i>	9
2.3	<i>Zona e Rreshqitjes Nr.2</i>	23
2.4	<i>Siguria dhe Shendetit ne pune</i>	36

1 ORGANIZIMI I PUNIMEVE

1.1 Hyrje

Bashkia Gjirokaster kerkon te realizoje Projekt Zbatimin, preventivin dhe vleresimin e kostove per implementimin e punimeve te ndertimit per :

1. Studim-Projektim 'Masa inxhinierike per stabilizimin e rreshqitjes se mases ne kodren e Cfakes, prane rruges nacionale Gjirokaster-Kakavije.

1a. Studim Gjeologo-Inxhinierik, shpime gjeologjike+analiza laboratorike per objektin e mases ne kodren e Cfakes, prane rruges nacionale Gjirokaster-Kakavije.

1.2 Te pergjithshme

Qellimi i pergjithshem i ketij projekti eshte parandalimi i demtimeve te objekteve nepermjet nderhyrjeve te menjehershme perforcuese, marrja e masave inxhinierike stabilizuese dhe monitorimi i vazhdueshem i rreshqitjeve per t'i paraprire situatave te rrezikshme.

Ky investim i **Bashkise Gjirokaster** do te eliminoje ne maksimumin e mundshem demtimet dhe plasaritjet e objekteve si dhe rreshqitjen e metejshme te masivit nepermjet zgjidhjes inxhinierike te problemit dhe venies se saj ne jete per te siguruar kushtet optimale te jeteses per banoret e saj.



Figura 1- Zona ku ka ndodhur rreshqitja

1.3 Punimet përgatitore për zbatimin e projektit

1.3.1 Te përgjithshme

Fazat e punimeve përgatitore janë si më poshtë:

1. Këto punime fillojnë me studimin e hollësishëm të projektit si dhe me përcaktimin e saktë të vendeve për ngritjen e kantiereve .
2. Përcaktimi i vendeve të karierave të materialeve dhe marrjen e lejeve përkatëse.
3. Para fillimit të punimeve kontraktori në bashkëpunim me investitorin dhe autoritetet e pushtetit lokal, të pajiset me azhurnimin e rrjeteve inxhinierike ekzistuese mbi dhe nëntokësore, mbi baze të cilave do të marrë lejet përkatëse.
4. Para fillimit të punimeve kontraktori duhet të pajiset me lejen mjedisore përkatëse

1.3.2 Njohja me Projektin

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te njihet hollesisht me projektin ne cdo detaj te tij. Paralelisht me njohjen e projektit Kontraktori duhet te bej shume vizita ne terren per tu njohur me situaten ekzistuese te zones dhe per ta krahasuar me ate te paraqitur ne projekt.

Kjo analize do ti mundesoje qe te verifikoje ndryshime te dukshme qe mund te jene bere me kalimin e kohes qe nga periudha e pergatitjes se Projekt Zbatimit.

Si rruge e emertuar e “kantierit” qe do te sherbejne per levizjen dhe ngritjen e sektoreve eshte parashikuar te jete vete trupi I rruges ekzistuese, me perjashtim te rasteve ku nuk ka mundesi ose nuk eshte e nevojshme.

1.3.3 Sigurimi i azhornimeve te rrjeteve ekzistuese dhe I lejeve nga Institucionet perkatese

Para fillimit te punimeve kontraktori ne bashkepunim me investitorin dhe autoritetet e pushtetit lokal, te pajiset me azhornimin e rrjeteve inxhinierike ekzistuese mbi dhe nentokesore, mbi baze e te cilave do te marrin lejet perkatese.

Para fillimi te punimeve Kontraktori duhet te pajiset me lejen mjedisore perkatese.

1.4 Punimet ne zonen e rreshqitjes

Punimet do te fillojne me rilevimet topografike te zones se projektit dhe verifikimet me projektin.

Per te proceduar me hapat e metejshem te ketyre punimeve Kontraktori mund te perzgjedhe te formoje disa grupe pune dhe te delegoje punimet ne dy apo disa fronte njekohesisht. Gjithsesi cdo lloj vendimarrje duhet te behet ne bashkepunim me Mbikqyresin e Punimeve.

Projektuesi e keshillon Kontraktorin qe per te mundesuar nje mbarvajtje te mire te punimeve te ndjeke grafikun e punimeve qe ai ka hartuar. Ne grafikun e punimeve eshte parashikuar qe per punimet qe duan me shume kohe, te punohet me dy turne. Nderhyrja per punimet qe do te kryhen ne pallatin 1 me zerat e punes sipas preventivit eshte parashikuar te zgjase 5muaj. E njejta kohezgjatje eshte parashikuar edhe per pallatin 2. Ky grafik eshte pjese e ketij projekti dhe paraqitet ne forme te permbledhur me poshte(grafiku i plote i bashkengjitet me vete projektit):




Figura 2- Grafiku i punimeve- Pallati 1




Figura 3- Grafiku i punimeve- Pallati 2

1.5 Detyrimet e Kontraktorit gjate Punimeve ne zonen e rreshqitjes

1.5.1 Te pergjithshme

Gjate zbatimit te punimeve kontraktori duhet te kete parasysh si me poshte:

- Duhet te punoje me pergjegjshmeri, te marre parasysh faktin qe zona eshte ne kushtet e stabilitetit kritik dhe realizimi i punimeve do te kryhet ne mot te thate me kujdesin me te madh per te mos shkaktuar deme te vogla apo te medha ne ndertesat qe gjenden ne pjesen e sipërme dhe ne pjesen e poshtme te zones se rreshkitur.
- Duhet te tregojë kujdes maksimal për të mos demtuar rrjetet ekzistuese nentokesore të cilat nuk preken nga punimet në zonë dhe në të cilat nuk është parashikuar nderhyrje.
- Duhet të tregojë kujdes dhe duhen marrë të gjitha masat për të siguruar që rruget të cilat përdoren qoftë për ndërtimin e punimeve ose për transportin e makinerive, punetoreve dhe materialeve, të mos ndoten si rezultat i ndërtimeve të tilla ose transportit dhe në raste të ndotjes duhen bërë të gjitha hapat e nevojshme për të pastruar ato sipas planit të menaxhimit mjedisor.
- Kontraktori duhet të kryejë vetë mirembajtjen dhe mbrojtjen e objektit gjatë ndërtimit por edhe mirembajtjen rutine derisa të merret në Dorezim në përputhje me kushtet e kontratës.
- Nëse Kontraktori do të punojë natën, ai duhet të paraqesë hollësi të plota të metodave të punës dhe ndriçimit dhe ndonjë informacion tjetër të nevojshëm.
- Gjatë gjithë fazës së zbatimit të punimeve kontrolli topografik duhet të jetë shumë rigoroz për vetë rëndësinë që ka objekti veçanërisht kuotat e strukturave mbajtëse, e rrjeteve të rrugës si dhe kanalizimeve të ujerave të bardha dhe ato të përdorura.

2 METODOLOGJIA E NDERTIMIT DHE ORGANIZIMI I PUNIMEVE

2.1 Te pergjithshme

Metodologjia e paraqitur me poshte, jep ne menyre orientuese metodologjine e ndertimit .Eshte pergjegjesi e Kontraktorit qe perpara fillimit te punimeve te pergatise dhe te paraqese per miratim tek Mbikqyresi i Punimeve - Metodologjine e detajuar si dhe Plan-Organizimin per kryerjen e punimeve te ndertimit te objektit te mesiperm. Permes ketij projekti do ti jepet zgjidhje teknike demtimit qe mund t'i vije banesave ekzistuese te cilat ndodhen shume afer me planin e rreshqitjes si dhe shnderrimin e kesaj pjese te qytetit nga nje zone me rrezik rreshqitjeje ne nje zone rekreative te sigurte dhe pa problematika.

2.2 Objektivat e kryesore

1. Rritja e qendrushmerise se shpatit dhe rritja e sigurise per objektet e ndikuara nga zona e rreshqitjes nepermjet sistemimit te skarpates, ndertimit te mureve mbajtes me sistem pilotash ne koken e rreshqitjes dhe ne fund te saj.
2. Frenimi i avancimit te fenomenit te rreshqitjes nepermjet sistemimit te ujrave. Do te kryhet sistemimi i ujrave te perdorura familjare,sistemimi i ujrave te kullimit te pallateve si dhe i ujrave siperfaqesore dhe nentokesore duke i larguar plotesisht nga skarpata ne studim.
3. Pyllezimi i hapësirave me bime qe pengojne zhvendosjen e masave te dheut.
4. Rikonstruksioni i rruges lidhese te objekteve ne zonen e rreshqitjeve nr. 1e cila eshte afektuar nga fenomeni i rreshqitjes dhe shtrimin e sheshit perreth pallatit te 2-te per te bere sistemimin e ujrave siperfaqesore.

2.3 Punime per ndertimin e masave stabilizuese te shpatit.

2.3.1 Pastrimi I vendit te punimeve

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te beje ne bashkepunim dhe me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve pastrimin e zones nga objekte fizike te cmontueshme dhe te panevojshme. Gjithashtu duhet te beje dhe pastrimin nga bimesia e ulet (nese ka) per te mundesuar sistemimin e mevonshem. Gjate fazes se pastrimeve Kontraktori duhet te kete parasysh qe pemet e larta ekzistuese qe gjenden ne zonen ku do te ndertohej nuk do te preken dhe do te ruhen te pademtuara gjate punimeve.

2.3.2 Ngritja e kantierit te punimeve

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te beje ne bashkepunim dhe me aprovimin e Mbikqyresit te Punimeve percaktimin e vendit ku do te ngrihet kantieri i punimeve.

Duhet pasur kujdes qe kantieri te mos ndertohet ne vende ku mund te ndikojne ne perkeqesimin e situates se krijuar te rreshqitjes ne zonen ne studim. Projektuesi sygjeron qe te percaktohet nje vend i pershtatshem prane zones ku ka ndodhur rreshqitja por jashte saj.

Projektuesi rekomandon qe punimet te kryhen ne kohe te thate, pa prani te ujrave nentokesore apo siperfaqesore te cilat mund te ndikojne negativisht ne proceset e punes.

2.3.3 Devijimi i perkohshem i rrjeteve ekzistuese

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te beje te gjitha devijimet e nevojshme te rrjeteve ekzistuese si ato te kanalizimeve te ujrave te perdorura apo te ujrave te shiut, si dhe rrjete te mundshme telefonie apo elektriciteti (ne bashkepunim me Autoritetet lokale dhe me miratimin e Mbikqyresit te punimeve). Devijimi i ujrave ne zonen ku do te punohet eshte i nevojshem pasi punimet duhet te realizohen ne toke te thate, pa prani ujrash nentokesore apo siperfaqesore.

2.3.4 Siguria gjate Punimeve

Kontraktori perpara fillimit te punimeve duhet te rrethoje kantierin dhe ndaloje cdo hyrje per persona te pa autorizuar. Kontraktori duhet te paraqese nje plan te menaxhimit te trafikut dhe te kufizimit te levizjes se banoreve te zones perreth, me ane te barrierave te betonit dhe te sinjalistikes perkatese deri ne perfundim te punimeve.

2.3.5 Piketimi I strukturave mbajtese

Piketimi i zones ku do te punohet dhe i strukturave do te kryhet me shume kujdes duke ju permbajtur raportit te hartuar dhe te dhenave te vendosura ne vizatimet perkatese.

2.4 Radha e realizimit te punimeve

Zona e rreshqitjes eshte e ndare ne 2 pjese, nga nje perrua, dhe si te tilla jane trajtuar me vete ne projekt, te pavarura dhe jane emertuar si :

- a) Zona e Rreshqitjes Nr.1–zona e shpatit lindor dhe verilindor e kodres, poshte Pallatit Nr.1
- b) Zona e Rreshqitjes Nr.2–zona e shpatit lindor e kodres, poshte Pallatit Nr.2



Figura 4- Plan i pergjithshem i zones se rreshqitjeve

2.2 Zona e Rreshqitjes Nr.1

Nga studimi i detajuar gjeologjik i realizuar ne vend nga ekspertet tane,u vu re nje plan rreshqitje i krijuar (shih raportin gjeologjik dhe profilet gjeologjike).

Per kete u be nje studim i hollesishem gjeoteknik per te shqyrtuar kushtet ku ndodhet zona ne fjale si dhe nje analizim i mirfillte inxhinierik per te percaktuar menyren e duhur per te stabilizuar situaten e krijuar.

Per stabilizimin e rreshqitjes poshte pallatit nr. 1 dhe banesave te z. Dritan Braho dhe z Alfred Rrapo jane marre masat inxhinierike te meposhtme:

1. Ndertimi i mureve me pilota (masa 1 dhe masa 3),
2. Mbrojtja e skarpates (poshte baneses se zotit Rrapo) me beton te sprucuar (masa 5),
3. Ndertimi i rruges prej betoni
4. Sistemimi i ujrave siperfaqesore dhe te ujrave te perdorura,

5. Sistemimi i zones me skarpata 5.5x2.5 m($\alpha= 24^\circ$) me bankina 2 m te gjera, te perforcuara me material geocell NPA 356 x100(kat B).
6. Mbjellja e zones se sistemuar me peme akacije dhe ndertime kanalesh me veshje multimat 100 ne fund te cdo skarpate.

Projektuesi rekomandon qe punimet te kryhen ne kohe te thate, pa prani te ujrave nentokesore apo siperfaqesore te cilat mund te ndikojne negativisht ne proceset e punes.




Figura 5- Plan i masave inxhinierike –Zona e rreshqitjes Nr. 1

Rradha e realizimit te punimeve ne zonen e rreshqitjes nr.1

Me qellim qe punimet qe do te kryhen te mos japin ndonje ndikim negativ/ose ndikim minimal ne destabilizimin e metejshem te zones,masat do te ndertohen sipas radhes se punimeve me poshte :

2.2.1 Ndertimi i Mases Nr.3 – Perde me pilota dhe mur b/a

Punimet do te fillojne me ndertimin e mases se 3-te e cila do te ruaje skarpaten se bashku me ndertesat mbi te, si dhe do te krijoje nje kufizim te levizjes se mases se paqendrueshme per te mbrojtur banesat ne fund te skarpates.

- a) Fillimisht bejme gati listen e makinerive dhe materialeve qe nevojiten per procesin e punes.
- b) Behet sistemimi i zones ku do te ndertohen pilotat per te mundesuar aksesin e makinerive qe do te nevojiten per realizimin e pilotave. Per kete fillimisht piketohet aksi i pilotave (shih koordinatat ne vizatimin perkates), Realizohet nje rruge provizore me gjeresi 3.5m me ane te nje eskavatori qe do te realizoje germimet dhe mbushjet e nevojshme (shih vizatimet). Duhet qe materiali te ngjshet mire ne menyre qe makineria te mos fundoset gjate punes dhe te humbase ekuilibrin.




Figura 6- Plani i rruges provizore per ndertimin e pilotave per mases 3




Figura 7- Seksion terthor tip i rruges provizore per ndertimin e pilotave

Pajisja qe do te perdoret per hapjen duhet te jete me permasa te tilla qe te mund te punoje me lehtesi ne rrugen e krijuar per kete qellim.

Duhet patur kujdes qe germimi te realizohet me faza,dhe me kujdes ne menyre te mos shkaktoje ndonje prishje ekuilibri te mundshme te skarpates. Materiali i germuar do te riperdoret per mbushjet e nevojshme per ndertimin e trupit te rruges provizore.

c) Pasi ndertohet rruga do te filloje procesi i ndertimit te pilotave. Projektuesi sygjeron qe ndertimi te filloje nga pika P09 (shih fig. 5) ne drejtim te pikes P10. Materiali i nxjerre nga germimi per pilotat do te largohet me kamion ne per ne vendin e depozitimit me te afert te percaktuar nga autoritetet lokale, ne bashkepunim me mbikqyresin e punimeve. Pasi betoni i pilotave te kete arritur 90% te klases (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpjtuës) ndertohet trau ne koke te pilotave dhe me pas muri mbi trau ne koke te pilotav ne kuotat dhe lartesiste e parashikuara ne projekt duke respektuar specifikimet teknike perkatese (shih vizatimet perkatese).




Figura 8- Pamje e perdes me pilota-masa nr. 3

2.2.2 Ndertimi i Mases Nr.1 – Rame me pilota dhe mur b/a

Pas ndertimit te perdes me pilota te mases nr.3 ne nje kohe sa me te shkurter duhet te filloje ndertimi i perdes me pilota per masen nr.1. Duke qene qe zona eshte ne kushte kritike ekuilibri punimet duhet te kryhen menjehere, per te siguruar qendrushmerine e pallatit Nr.1 dhe banesen e z.Braho. Projektuesi rekomandon qe te respektohet koha qe i nevojitet betonit te pilotave per te arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues) perpara se te fillojne punimet per ndertimin e perdes me pilota te mases nr.1.

Per kete :

- a) Fillimisht me ane te makinerive do te sistemohet zona ku do te ndertohet perdja me pilota per masen nr. 1. Ky sistemim do te sherbeje me vone per ndertimin e rruges prej betoni.




Figura 9- Seksion terthor tip i sistemimit per ndertimin e pilotave

- b) Do te filloje ndertimi i pilotave. Projektuesi rekomandon fillimin e ndertimit te pilotave nga pika P7 ne drejtim te pikes P1 ne menyre qe te mund te behet dhe largimi i materialit te germuar me kamion per ne vendin e depozitimit me te afert te percaktuar nga Autoritetet lokale, ne bashkepunim me Mbikqyresin e punimeve.




Figura 10- Pamje e perdes me pilota-masa nr. 1

- c) Pasi betoni i pilotave te kete arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues), do te filloje ndertimi i pilotave ne rreshtin e dyte (Figura 10). Kjo per arsye qe mos te shkaktohet ndonje demtim i mundshem nga punimet e vazhdueshme, dhe zona te jete e siguruar para se te behen nderhyrje te tjera. Fillimisht do te behet piketimi i aksit ku do te vendosen pilotat duke ndjekur pikat P2, P4, P6, P8 dhe pastaj do te vazhdohet me shpimin e sondave dhe betonimin. Ne vazhdimesi te punimeve do te ndertohen traret lidhes te pilotave dhe traret midis rrjeshtave te pilotave qe do te krijojne nje strukture rame me shtangesi te larte. Projektuesi rekomandon qe perpara ndertimit te trareve lidhes midis rrjeshtave te pilotave materiali i dheut mbushes apo tabanit natyral te ngjishet mire ne menyre qe struktura te mos pesoje ulje qe mund te japin demtime .
- d) Pasi e gjithe struktura te kete arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues) , Kontraktori mund te vazhdoje te ndertoje muret e betonit mbi traret e pilotave sic parashikohet ne projekt(shih vizatimet perkatese).




Figura 11- Pamje e mases nr.1




Figura 12- Profil gjatesor i Perdes me pilota dhe murit b/a ne koke te pilotave

2.2.3 Ndertimi i Mases Nr.5 –Beton i sprucuar

Duke qene se zona ku do te ndertohej masa nr.5 eshte e pavarur dhe nuk ndikon ne stabilitetin e pergjithshem te zones poshte pallatit nr.1, kontraktori mund te realizoje punimet e mases nr. 5 njekohesisht me punimet e tjera te betonit. Shotcrete (betoni i sprucuar) do te jete 15 cm, me rrjete metalike Ø8 (15x15) cm, anker Ø=32 dhe tuba drenimi.

Realizimi i tyre ndjek kete radhe:

- Fillimisht bejme gati listen e makinerive dhe materialeve qe nevojiten per procesin e punes.
- Behet pastrimi i faqes qe do te vishet, nga masa dhe te rreshkitura nga zona mbi skarpate.
- Realizohet sprucimi i shtreses se pare me shotcrete me trashesi 5 cm.
- Ankerohet skarpata me ankor Ø=32, L=3m, $\alpha=10^\circ$ (2x2)m.
- Vijojme me injektimin e cimentos ne anker.
- Me tej vazhdojme me drenazhimin e skarpates, vendoim tuba drenazhi Ø=50, me gjatesi L=2m, dhe kendi me horizontalen $\alpha=14^\circ$, me hap (2x2)m.
- Presim 15 dite qe cimento te arrije klasen pastaj bejme proven e terheqjes se ankerit ne ngarkesen 210 bar.
- Vendosim zgarat e hekurit (lidhja e zgarave me ankerin dhe mbivendosja e zgarave 2 kuadrate/ 20 cm minimum)
- Ne fund behet sprucimi I betonit per shtresen e dyte 10 cm.

Shenim: Gjate sprucimit tubat e drenazhit duhet te mbulohen me leter ose gjeotekstil qe te mos bllokohen.



Figura 13- Shembull per punimet e betonit te sprucuar




Figura 14- Masa nr. 5-Beton i sprucuar me anker

2.2.4 Ndertimi rrjetit te kanalizimeve te ujrave te shiut dhe te ujrave te perdorura.

Pasi te kete perfunduar procesi i ndertimit te masave inxhinierike mbajttese- perde dhe rama me pilota, do te filloje te realizohet ndertimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te perdorura dhe ujrave atmosferike.

Projektuesi ka treguar kujdes te vecante ne ndertimin e rrjetit te kanalizimeve duke larguar te gjitha ujrat e mundshme te shiut dhe te ujrave te perdorura nga zona ku ka ndodhur rreshqitja, dhe duke i orientuar ato ne disa pika kryesore qe lidhen me rrjetin kryesor te rruges me te afert ose duke i shkarkuar ato ne perrua.

Do te vendosen tubacionet dhe pusetat e parashikuara ne projekt (shih vizatimet perkatese) ne kuotat e percaktuara (shih vizatimet dhe raportin hidrologjik). Pusetat dhe tubacionet qe ndodhen ne zona ku parashikohet mbushje do te ndertohen paraprakisht , perpara se te realizohen punimet e mbushjes. Eshte e rendesishme qe te vendoset nje shtrese rere prej 10 cm poshte tubacioneve ne menyre qe te mbrohet tubi nga deformime te mundshme.

Ne pikat e lidhjes me rrjetin ekzistues, per shkak te ndryshimit te madh te kuotave, tubin i cili shoqeron murin ekzistues mbrohet nga nje kemishe betoni. Kjo zgjidhje u dha per te eliminuar germimet e shumta dhe per te mbrojtur strukturat ekzistuese(mure mbajtes ekzistues.)

Nese eshte e mundur ,sipas kushteve te terrenit, Kontraktori mund te ndryshoje/pershtase vendosjen e pusetave me miratimin e mbikqyresit te punimeve. Ndertimi i pusetave do te behet sipas detajeve dhe specifikimeve perkatese .

Shenim :

Puseta MSP-1 eshte projektuar me permasa 150x150x100 cm per arsye te lidhjes ne te te shume tubacioneve. Pavaresisht ndertimit ose jo te masave inxhinierike ne pallatin 2, kjo pusete duhet te ndertohet ne permasat e dhena ne projekt. Gjithashtu linja e tubacionit AS2-3, e cila eshte vazhdimi i pusetes MSP-1 per te bere lidhjen e sistemit te kanalizimeve te ujrave te perdorur me rrjetin ekzistues ne piken e percaktuar nga Bashkia (Shkresa Prot. 8562, Dt 07.12.2018), do te ndertohet pavarsisht nese masat inxhinierike te pallatit 2 do te realizohen apo jo.

2.2.5 Ndertimi Rruges se betonit

Pasi te kete perfunduar procesi i ndertimit te masave inxhinierike mbajttese- perde dhe rama me pilota Kontraktori fillon punimet per ndertimin e rruges se betonit.

a) Piketimi i aksit te rruges

Piketimi i aksit dhe elementeve te tjere te trupit te rruges do te kryhet me shume kujdes duke ju permbajtur te dhenave te vendosura ne vizatimet perkatese.

b) Punimet e Germimit

Punimet e germimit do te fillojne pasi te jete bere piketimi ne perputhje me planet e germimeve si dhe azhurnimi dhe verifikimi i sistemeve ekzistuese nentokesore. Gjithashtu perpara fillimit te

germimëve duhet të verifikohen në vend sistemet e infrastruktures nëntokesore si dhe sipas të dhenave të siguruar nga Autoritetet përkatëse.

Germimet do të kryhen sipas vizatimeve të miratuara duke respektuar përmasat në plan dhe kuotat.

Per germimin do të përdoren makineri të përshtatshme (ekskavatore, kamione). Makinerite do të përdoren vetëm nga personel i specializuar dhe i pajisur me lejet përkatëse të drejtimit.

Materiali i dalë nga germimet i cili nuk do të përdoret si material për mbushje do të depozitohet në vendet e miratuara nga Autoritetet përkatëse, ndërsa materiali i cili do të konsiderohet i përshtatshëm për të bërë mbushje (jo në trupin e rruges) do të depozitohet në vendin e caktuar në kantiër për tu ripërdorur sipas udhëzimeve të projektit.

Në përfundim të procesit të germimit do të bëhet kontrolli topografik për të verifikuar përputhshmërinë me projektin. Në rast se thellesia e germimit shkon më poshtë se ajo e projektit atëherë lartësia e tejkalluar do të mbushet me material të përshtatshëm dhe do të ngjishet në përputhje me specifikimet teknike.

c) Punimet e Mbushjeve

Punimet e mbushjeve do të fillojnë pasi të jete kontrolluar dhe miratuar germimi. Mbushjet do të bëhen me material në përputhje me specifikimet teknike i cili do të zgjidhet nga germimi ose do të importohet nga burime të miratuara.

Gjate mbushjeve tabani do të mbahet i drenazhuar. Materiali mbushës do të nivelohet dhe ngjishet me shtresa sipas specifikimeve teknike. Për ngjeshjen do të përdoren rrula ose pajisje/makineri të tjera të përshtatshme dhe të miratuara me pare të cilat sigurojnë ngjeshjen e nevojshme sipas projektit dhe specifikimeve teknike.

d) Punimet e shtresave

Perpara fillimit të punimeve të shtresave rrugore duhet :

- Te sigurohet që germimi i profilit tërthor të rruges është në përputhje me projektin,
- Te ngjishet tabani natyror i trupit të rruges,
- Te këna përfunduar punimet e strukturave të ndryshme (si puseta, mure, etj.) që janë nën sipërfaqen e rruges.

Shtresat e rruges nga tabani deri tek shtresa e betonit përbehen nga nënshtresa dhe shtresa baze. Materialet e shtresave merren nga lumenjte, guroret ose burime të tjera të miratuara. Trashësia dhe ngjeshja e shtresave duhet të jete në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike. Përhapja dhe ngjeshja e shtresave duhet të realizohet me makineri të përshtatshme dhe të miratuara me pare. Asnjë kurriz nuk duhet të formohet kur shtresa të jete mbaruar përfundimisht. Shtresa e ngjeshur përfundimisht nuk duhet të ketë sipërfaqe jo të njëtrajtshme, ndarje midis agregateve të imta dhe të trasha, rrudha ose defekte të tjera.

Në përfundim të çdo shtrese duhet të bëhet kontrolli topografik dhe provat e ngjeshjes.

Perpara se të fillojnë shtresat e betonit duhet të sigurohet që:

- Permasat ne plan dhe kuote e trupit te rruges te jene brenda tolerancave te dhena ne projekt dhe specifikimet teknike,
- ngjeshja e shtresave eshte ne perputhje me specifikimet,
- cilesia e betonit eshte ne perputhje me projektin dhe specifikimet.

Lloji, trashesia dhe kerkesat teknike te betonit do te jene ne perputhje me projektin e zbatimit. Perhapja e shtresave te betonit do te kryhet me makineri te pershtatshme te cilat sigurojne shperndarje te njetrajtshme.

Ne perfundim te shtresave te betonit duhet te behet kontrolli per kuotat dhe cilesine e shtresave. Siperfaqja e shtreses se betonit duhet te jete brenda tolerancave te dhena ne projekt dhe specifikimet teknike. Kontrolli qe percakton cilesite kryesore te betonit te vendosur e ngjeshur ne veper percaktohen me prova laboratorike.

2.2.6 Sistemimi i Skarpates (Geocell)

Ne te njejten kohe me punimet per realizimin e trupit te rruges , Kontrafaktori mund te punoje per sistemimin e skarpates, me ane te mbushjeve dhe germimeve nevojshme per te realizuar skarpatat dhe bankinat , ne kuotat e percaktuara ne projekt(shih viatimet perkatese). Mbushjet do te realizohen me material te perzgjedhur vegjetal,qe do te lejoje pyllzimin e zones dhe ne perfundim te punimeve do te mbillet me bar, duke krijuar keshtu nje zone te gjelberuar.

➤ *Stabilizimi i skarpates me teknologjine Geocell NPA*

Stabilizimi i skarpates do te realizohet me ane te materialit perforcues Geocell me fibra polipropileni me kapacitet te larte , nje teknologji e cila na lejon qe per mbushje me te vogla te sigurojme stabilitetin e skarpatave me siperfaqe te konsiderueshme duke e siguruar ate nga rreshqitja apo shkeputja e masave te skarpatave.

Pikat kyçe para fillimit te montimit te Rrjetit Geocell :

1. Sigurohuni qe te gjitha materialet e specifikuara dhe lloji / gjeresia e sakte e Geocell te dorezohen ne vend, te pa demtuara dhe te gatshme per perdorim.
2. Sigurohuni te keni materialet e pershtatshme dhe mjetet e kerkuara te tilla si, ankorat, kapesit pneumatik (dhe kapeset), kompresor ajri dhe burim energjie; gjeogridet dhe gjeotekstilet nese specifikohet.
3. Sigurohuni qe seksionet dhe hapjet e qelizave jane ne drejtim, shtrirje dhe lartesi siç tregohet ne vizatimet e ndertimit.
4. Qelizat bosh - mos ecni ne qeliza te ekspozuara. Edhe pse qelizat jane te ngurta, Geocell eshte nje sistem i perbere qe punon vetem kur mbushet me material. Ecja ne qeliza bosh mund te beje qe muret e qelizave dhe performanca e sistemit te demtohet. Perdorni derrasa per te ecur neper qelizat bosh nese eshte e nevojshme.
5. Automjetet nuk mund te operohen direkt ne Geocell te ekspozuar ne çdo kohe; gjate procesit te mbushjes sigurohuni qe qelizat Geocell te mos demtohen nga pajisjet mekanike.
6. Sigurohuni qe punonjesit te njihen dhe t'i permbahen standardeve dhe procedurave te sigurise.

7. Mjedisi - te kryhen aktivitetet ndertimore ne perputhje me te gjitha udhezimet e aplikueshme per te minimizuar ndikimet mjedisore.

		
Seksionet geocell ne paleta	Seksionet geocell te hapura ne shesh	Kunjat, shufrat, tendinat Geocell
		
Gjeotekstil (nese specifikohet)	Kapesi pneumatik dhe kapeset e galvanizuara 13 mm	Kompresori dhe gjeneratori i ajrit (Presion 60 psig / 4 bar) Dhe cekic pneumatik me kokë për piketimet (opsionale)

Figura 15- Mjetet dhe materialet e nevojshme

Punimet per montimin e Geocell :

- a) Pregatitja e skarpates ku do te montohet Geocell
 - Pergatitet nenbaza e skarpates siç tregohet ne vizatimet e ndertimit ose siç udhezohet nga Inxhinieri ne vend. Behet procesi i germim/mbushje,pastrohet siperfaqja nga gjelberimi, shkembinj, mbeturina, trungje, rrenje dhe toke te papranueshme.
 - Nivelohet siperfaqja e skarpates sipas lartesisve dhe kuotave te planifikuara.
 - Behet verifikimi qe nuk ekzistojne boshlleqe nen toke.Gjithashtu sigurohemi qe shtresa e siperme e tokes te jete e lemuar, pa gure te medhenj.
- b) Pregatitet zona ku do te ankorohet geocell, ne distance 80 cm .
- c) Fiksohen kunjat ne fillim te skarpates
- d) Orientoni seksionet ne drejtimin e duhur.
 - Seksionet e mbyllura duhet te jene paralel me skarpaten (gjatesine).
 - Seksionet e hapura do te zgjerohen poshte skarpates (gjeresia).



Figura 16- Pregatitja e ankorimit te Geocell

Skarpata shume te gjata mund te instalohen ne segmente. Kapen grupet e seksioneve me njeri-tjetrin duke zgjeruar secilin grup te seksioneve poshte. Mund te perdoren nje sere hendeqesh horizontale ne intervale te nje shpati shume te gjate, sidomos per instalim mbi gjeomembrane. Kanalet mund te mbushen me çanta rere per te ankoruar Geocellet ne intervale fikse, duke zgjeruar segmentet poshte.

e) Mbushja me dhe e Geocellit

Mbushja realizohet mekanikisht duke perdorur materialin mbushes dhe vegjetal sipas procedurave standarde te punimeve dhe ne perputhje te plote me specifikimet e projektit. Kujdes duhet te behet per te parandaluar formimin e boshlleqeve dhe per te parandaluar demtimin e mureve te Geocell. Madhesia e kokrrizave te dheut nuk duhet te kaloje 1/3 e madhesise se qelizes.

Para fillimit te operacioneve te mbushjes:

- Vizualisht inspektoni mbushjen dhe hiqni çdo pjese te madhe te mbeturinave, tokes ose gureve (me te medhenj se 1/3 e nje qelize) per te parandaluar demtimin e mureve te qelizave.
- Kontrolloni qe te gjitha kunjat te futen ne thellesine e duhur.
- Kapese te veçanta opsionale mund t'i bashkengjiten kunjave per te mbajtur ne vend qelizat / seksionet.

Ne fillim mbushen rreshtat e qelizave ne majen e skarpates. Vendoset dhe shperndahet mbushja nga lart poshte derisa te gjitha qelizat te plotesohen.

Shenime :

- Mos perdorni makineri mbi qelizat e hapura
- Kufizoni lartesine e renies se mbushjes nen 1m (100 cm) per te parandaluar demtimin e mureve te qelizave.
- Mbimbushni qelizat Geocell mbi muret e qelizave (4-6 cm)per te lejuar mbushjen e plote pas ngjeshjes.
- Ngjeshni token. Pjesa e prapme e lopates te nje ekskavatori mund te perdoret per kete.
- Toka e ngjeshur duhet te jete min 1-2 cm mbi muret e qelizave.
- Perhapni manualisht mbushjen nese eshte e nevojshme per te siguruar mbushje uniforme dhe qe te mos ekspozohen muret qelizore.

Per instalimin ne menyre korrekte dhe konform rregullave ne aneksin bashkengjitur paraqitet manuali i plote i instalimit te Geocell.

➤ *Pyllezimi me peme akacje*

Do te behet pyllezimi i zones me peme akacje 2 vjecare, te vendosura cdo 4 m nga njera tjetra. Pema akacje eshte zgjedhur per shkak te aftesise se saj per te thithur sa me shume uje. Ne kete menyre skarpata do te jete gjate gjithë kohes pa prani ujrash ose me prani minimale te ujit.

➤ *Ndertimi i kanaleve ne fund te skarpates*

Pasi te realizohet stabilizimi i skarpatave procesi i punes do te vijoje me sistemimin e bankinave, krijimin e trupit te kanaleve ne fund te skarpates dhe veshjen e tyre me material Multimat 100 - geomat tre dimensional qe perdoret per te perforcuar kanalim dhe per ta mbrojtur ate nga erozioni per shkak te pjerresise se vete kanalit.

2.3 Zona e Rreshqitjes Nr.2

Nga studimi i detajuar gjeologjik i realizuar ne vend nga ekspertet tane,u vu re nje plan rreshqitje i krijuar (shih raportin gjeologjik dhe profilet gjeologjike).

Per kete u ben nje studim i hollesishem gjeoteknik per te shqyrtuar kushtet ku ndodhet zona ne fjale dhe u ben je analizim i mirfillte inxhinierik per te percaktuar menyren e duhur per te stabilizuar situaten e krijuar.

Per stabilizimin e rreshqitjes poshte pallatit nr. 2 dhe jane marre keto masa inxhinierike:

1. Ndertimi i mureve me pilota (masa 2 dhe masa 4),
2. Sistemimi i ujrave siperfaqesore dhe te ujrave te perdorura,
3. Sistemimi i sheshit dhe rrugicave

4. Sistemimi i zones me skarpata 5.5x2.5 m($\alpha=24^\circ$) me bankina 2 m te gjera, te perforcuara me geocell NPA 356 x100(kat B).
5. Mbjellja e zones se sistemuar me peme akacije dhe ndertime kanalesh me veshje multimat 100 ne fund te cdo skarpate.

Projektuesi rekomandon qe punimet te kryhen ne kohe te thate, pa prani te ujrave nentokesore apo siperfaqesore te cilat mund te ndikojne negativisht ne proceset e punes.



Figura 17- Plan i masave inxhinierike –Zona e rreshqitjes Nr. 1

Rradha e realizimit te punimeve ne zonen e rreshqitjes nr.2

Me qellim qe punimet qe do te kryhen te mos japin ndonje ndikim negativ/ose ndikim minimal ne destabilizimin e metejshem te zones,masat do te ndertohen sipas radhes se punimeve me poshte :

2.3.1 Ndertimi i Mases Nr.4 – Perde me pilota

Punimet do te fillojne me ndertimin e mases se 4-te e cila do te ruaje skarpaten se bashku me ndertesat mbi te, si dhe do te krijoje nje kufi ne levizjes se mases se paqendrueshme per te mbrojtur banesat ne fund te skarpates.

- d) Fillimisht bejme gati listen e makinerive dhe materialeve qe nevojiten per procesin e punes.
- e) Behet sistemimi i zones ku do te ndertohen pilotat per te mundesuar aksesin e makinerive qe do te nevojiten per realizimin e pilotave. Per kete fillimisht piketohet aksi i pilotave (shih koordinatat ne vizatimin perkates), Do te krijohet nje rruge provizore me gjersi 3.5m me ane te nje eskavatori qe do te realizoje mbushjet dhe germimet e nevojshme (shih vizatimet). Duhet qe materiali te ngjishet mire ne menyre qe makineria te mos fundoset gjate punes dhe te humbase ekuilibin.




Figura 18- Plani i rruges provizore per ndertimin e pilotave per masen 4




Figura 19- Seksion terthor tip i rruges provizore per ndertimin e pilotave

Pajisja qe do te perdoret per hapjen duhet te jete me permasa te tilla qe te mund te punoje me lehtesi ne rrugen e krijuar per kete qellim.

Duhet patur kujdes qe germimi te realizohet me faza,dhe me kujdes ne menyre te mos shkaktoje ndonje prishje ekuilibri te mundshme te skarpates. Materiali i germuar do te riperdoret per mbushjet e nevojshme per ndertimin e trupit te rruges provizore.

f) Pasi ndertohet rruga do te filloje procesi i ndertimit te pilotave. Projektuesi sygjeron qe ndertimi te filloje nga pika P09 (shih fig. 17) ne drejtim te pikes P08. Materiali i nxjerre nga germimi per pilotat do te largohet me kamion ne per ne vendin e depozitimit me te afert te percaktuar nga Autoritetet lokale, ne bashkepunim me Mbikqyresin e punimeve. Pasi betoni i pilotave te kete arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues), ndertohet trau dhe muri mbi pilota ne kuotat dhe lartesishte e parashikuara ne projekt duke respektuar specifikimet teknike perkatese (shih vizatimet perkatese).




Figura 20- Pamje e perdes me pilota-masa nr. 4

2.3.2 Ndertimi i Mases Nr.2 – Rame me pilota

Pas ndertimit te perdes me pilota te mases nr.4 ne nje kohe sa me te shkurter duhet te filloje ndertimi i perdes me pilota per masen nr.2. Duke qene qe zona eshte ne kushte kritike ekuilibri punimet duhet te kryhen menjehere, per te siguruar dhe ruajtur Pallatin nr 2. Projektuesi rekomandon qe te pakten, te respektohet koha qe i nevojitet betonit te pilotave per te arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpjtuues) perpara se te fillojne punimet per ndertimin e perdes me pilota te mases nr. 2.

Per kete :

- e) Fillimisht me ane te nje makinerie do te sistemohet zona ku do te ndertohej perdja me pilota per masen nr. 2.




Figura 21- Seksion terthor tip i sistemimit per ndertimin e pilotave

- f) Do te filloje ndertimi i pilotave .Projektuesi rekomandon fillimin e ndertimit te pilotave nga pika P1 ne drejtim te pikes P5 ne menyre qe te mund te behet dhe largimi i materialit te germuar me kamion per ne vendin e depozitimit me te afert te percaktuar nga Autoritetet lokale, ne bashkepunim me Mbikqyresin e punimeve.




Figura 22- Pamje e perdes me pilota-masa nr. 2

- g)** Pasi betoni i pilotave te kete arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues), do te filloje ndertimi i pilotave ne rreshtin e dyte (Figura 22). Kjo per arsye qe mos te shkaktohet ndonje demtim i mundshem nga punimet e vazhdueshme, dhe zona te jete e siguruar para se te behen nderhyrje te tjera. Fillimisht do te behet piketimi i aksit ku do te vendosen pilotat duke ndjekur pikat P6 dhe P7 dhe pastaj do te vazhdohet me shpimin e sondave dhe betonimin. Ne vazhdimesi te punimeve do te ndertohen traret lidhes te pilotave dhe traret midis rrjeshtave te pilotave qe do te krijojne nje strukture rame me shtangesi te larte. Projektuesi rekomandon qe perara ndertimitt te trareve lidhes midis rrjeshteve te pilotave materiali i dheut mbushes apo tabanit natyral te ngjishet mire ne menyre qe struktura te mos pesoje ulje qe mund te japin demtime .
- h)** Pasi e gjithë struktura te kete arritur 90% te klases se percaktuar (min 7 dite ne rastin e betonit me aditiv pershpejtues) , kontraktori mund te vazhdoje te ndertoje muret e betonit mbi traret e pilotave sic parashikohet ne projekt (shih vizatimet perkatese).




Figura 23- Pamje e mases nr.2




Figura 24- Profil gjatesor i Perdes me pilota dhe murit b/a ne koke te pilotave

2.3.3 Ndertimi rrjetit te kanalizimeve te ujrave te shiut dhe te ujrave te perdorura.

Pasi te kete perfunduar procesi i ndertimit te masave inxhinierike mbajttese- perde dhe rama me pilota, do te filloje te realizohet ndertimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te perdorura dhe te shiut .

Projektuesi ka treguar kujdes te vecante ne ndertimin e rrjetit te kanalizimeve duke larguar te gjitha ujrat e mundshme te shiut dhe te ujrave te perdorura nga zona ku ka ndodhur rreshqitja, dhe duke i orjentuar ato ne disa pika kryesore qe lidhen me rrjetin kryesor te rruges me te afert ose duke i shkarkuar ato ne perrua.

Do te vendosen tubacionet dhe pusetat e parashikuara ne projekt (shih vizatimet perkatese) ne kuotat e percaktuara (shih vizatimet dhe raportin hidrologjik).

2.3.4 Sistemimi i sheshit me shtrese betoni

Pasi te kete perfunduar procesi i ndertimit te masave inxhinierike mbajttese- perde dhe rama me pilota Kontraktori fillon punimet per sistemimin e sheshit perreth pallatit nr. 2 dhe rruges se kembesoreve qe lidh zonen 1 me zonen 2 te rreshqitjes.

Sistemimi do te behet me mbushje germime te vogla, duke ruajtu pak a shume kuotat e terrenit ekzistues dhe me pjerresi ne drejtim te pusetave te shiut qe jane vendosur ne kete shesh me qellim grumbullimin dhe kanalizimin e ujrave te shiut ne menyre qe te mos lejohet shkarkimi i tyre ne zonen e skarpates ku jane marre masa per mbrojtjen nga rreshqitja.

e) Punimet e shtresave

Perpara fillimit te punimeve te shtresave te sheshit duhet :

- Te sigurohet qe germimi i profilit terthor te rruges eshte ne perputhje me projektin,
- Te ngjshet tabani natyror i sheshit
- Te kene perfunduar punimet e strukturave te ndryshme (si puseta, mure, etj.) nese ka

Shtresat e nen shtresen e betonit do te jete shtrese prej cakelli. Materialet e shtresave merren nga lumenjte, guroret ose burime te tjera te miratuara. Trashesia dhe ngjeshja e shtresave duhet te jete ne perputhje me projektin dhe specifikimet teknike. Perhapja dhe ngjeshja e shtresave duhet te realizohet me makineri te pershtatshme dhe te miratuara me pare. Asnje kurriz nuk duhet te formohet kur shtresa te jete mbaruar perfundimisht. Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk duhet te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis agregateve te imta dhe te trasha, rrudha ose defekte te tjera.

Ne perfundim te çdo shtrese duhet te behet kontrolli topografik dhe provat e ngjeshjes.

Perpara se te fillojne shtresat e betonit duhet te sigurohet qe:

- ngjeshja e shtresave eshte ne perputhje me specifikimet,
- cilesia e betonit eshte ne perputhje me projektin dhe specifikimet.

Lloji, trashesia dhe kerkesat teknike te betonit do te jene ne perputhje me projektin e zbatimit. Perhapja e shtresave te betonit do te kryhet me makineri te pershtatshme te cilat sigurojne shperndarje te njetrajtshme.

Ne perfundim te shtresave te betonit duhet te behet kontrolli per kuotat dhe cilesine e shtresave. Siperfaqja e shtreses se betonit duhet te jete brenda tolerancave te dhena ne projekt dhe specifikimet teknike. Kontrolli qe percakton cilesite kryesore te betonit te vendosur e ngjeshur ne veper percaktohen me prova laboratorike.

2.3.5 Sistemimi i Skarpates(Geocell)

Ne te njejten kohe me punimet per realizimin e trupit te rruges , Kontraktori mund te punoje per sistemimin e skarpates, me ane te mbushjeve dhe germimeve nevojshme per te realizuar skarpatat dhe bankinat , ne kuotat e percaktuara ne projekt(shih viatimet perkatese). Mbushjet do te realizohen me material te perzgjedhur vegjetal,qe do te lejoje pyllzimin e zones dhe ne perfundim te punimeve do te mbillet me bar, duke krijuar keshtu nje zone te gjelberuar.

➤ *Stabilizimi i skarpates me Geocells*

Stabilizimi i skarpates do te realizohet me ane te materialit perforcues Geocell, nje teknologji e cila na lejon qe per mbushje me te vogla te sigurojme stabilitetin e skarpatave me siperfaqe te konsiderueshme duke e siguruar ate nga rreshqitja apo shkeputja e masave te skarpatave.

Pikat kyçe para fillimit te montimit te Geocell :

8. Sigurohuni qe te gjitha materialet e specifikuar dhe lloji/ gjeresia e sakte e Geocell te dorezohene vend, te pa demtuara dhe te gatshme per perdorim.
9. Sigurohuni te keni materialet e pershtatshme dhe mjetet e kerkuara te tilla si, ankorat, kapesit pneumatik (dhe kapeset), kompresor ajri dhe burim energjie gjeogridet dhe gjeotekstilet nese specifikohet.
10. Sigurohuni qe seksionet dhe hapjet e qelizave jane ne drejtim, shtrirje dhe lartesi siç tregohet ne vizatimet e ndertimit.
11. Qelizat bosh - mos ecni ne qeliza te ekspozuara. Edhe pse qelizat jane te ngurta, Geocell eshte nje sistem i perbere qe punon vetem kur mbushet me material. Ecja ne qeliza bosh mund te beje qe muret e qelizave dhe performanca e sistemit te demtohet. Perdorni derrasa per te ecur neper qelizat bosh nese eshte e nevojshme.
12. Automjetet nuk mund te operohen direkt ne Geocell te ekspozuar ne çdo kohe gjate procesit te mbushjes sigurohuni qe qelizat Geocell te mos demtohen nga pajisjet mekanike.
13. Kontraktori duhet te sigurohet qe punonjesit te njihen dhe t'i permbahen standardeve dhe procedurave te sigurise.
14. Mjedisi - te kryhen aktivitetet ndertimore ne perputhje me te gjitha udhezimet e aplikueshme per te minimizuar ndikimet mjedisore.

		
Seksionet geocell ne paleta	Seksionet geocell te hapura ne shesh	Kunjat, shufrat, tendinat Geocell
		
Gjeotekstil (nese specifikohet)	Kapesi pneumatik dhe kapeset e galvanizuara 13 mm	Kompresori dhe gjeneratori i ajrit (Presion 60 psig / 4 bar) Dhe cekic pneumatik me kokë për piketimet (opsionale)

Figura 25- Mjetet dhe materialet e nevojshme

Punimet per montimin e Geocell :

- f) Prgatitja e skarpates ku do te montohet Geocell
- Prgatitet nenbazen e skarpates siç tregohet ne vizatimet e ndertimit ose siç udhezohet nga Inxhinieri ne vend. Behet procesi i germim/mbushje,pastrohet siperfaqja nga gjelberimi, shkembinj, mbeturina, trungje, rrenje dhe toke te papranueshme.
 - Nivelohet siperfaqja e skarpates sipas lartesive dhe kuotave te planifikuara.
 - Behet veriikimi qe nuk ekzistojne boshlleqe nen toke.Gjithashtu sigurohemi qe shtresa e siperme e tokes te jete e lemuar, pa gure te medhenj.
- g) Prgatitet zona ku do te ankorohet geocell, ne distance 80 cm .
- h) Fiksohen kunjat ne fillim te skarpates
- i) Orientoni seksionet ne drejtimin e duhur.
- Seksionet e mbyllura duhet te jene paralel me skarpaten (gatesine).
 - Seksionet e hapura do te zgjerohen poshte skarpates (gjeresia).



Figura 26- Pregatitja e ankorimit te Geocell

